



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Rule of Law Initiative

FTESË

Prezantimi i Raporteve Informuese mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave në Shqipëri

23 Nëntor 2022, 10:00 – 12:00

Vendi: Hotel “Tirana International”, Salla Metropol

Raporti i fundit i MONEYVAL i publikuar në maj 2022 njoftoi se Shqipëria nuk ka përmirësuar ndjeshëm masat për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me rekomandimet e FATF-së dhe për rrjedhojë mbetet në procedurën mbikëqyrjes së shtuar.

Prej vitit të kaluar, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim po ndërmerr një nismë që synon, ndër të tjera nxitjen e angazhimit ndërsektorial duke bërë bashkë shoqërinë civile, akademinë, median dhe shoqatat e sektorit privat rreth qëllimeve dhe përpjekjeve të përbashkëta në fushën e parandalimit të pastrimit të parave.

Shoqëria civile, academia (universitetet dhe qendrat kërkimore), dhe mediat investigative kryesisht e kanë kufizuar vëmendjen e tyre në hetimin dhe raportimin e aktiviteteve kriminale, por ende nuk kanë bërë një hap më tej për t'u fokusuar në mënyrë sistematike në procesin e pastrimit të parave dhe sfidat për Shqipërinë. Një nga sfidat kryesore në këtë drejtim është mungesa e kapaciteteve dhe njohurive të specializuara nga këta aktorë.

Gjithashtu, nismat e përbashkëta të shoqërisë civile, medias dhe universitetet mund të veprojnë si një mjet i fuqishëm ndërgjegjësimi dhe informimi jo vetëm për palët e mundshme të interesit por edhe për publikun në përgjithësi. Një strategji e tillë çon në rritjen e përpjekjeve dhe performancës së vendit në luftën dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe arritjen e rezultateve të qëndrueshme në të.

Për këtë qëllim, janë prodhuar tre raporte informuese mbi performancën e Shqipërisë në luftën ndaj pastrimit të parave të cilat trajtojnë tema të zgjedhura në këndvështrimin institucional, të politikëbërjes dhe të medias. Ky forum do shërbejë për të prezantuar punimet e ekspertëve dhe për të nxitur një diskutim të gjithanshëm mbi disa prej çështjeve më të ndjeshme të pastrimit të parave në Shqipëri.

Forumi do të mbahet më **23 nëntor**, ora **10:00 – 12:00**, te **Hotel “Tirana International”, Salla Metropol**.

Ju lutemi të konfirmoni pjesëmarrjen në adresën: dproni@idmalbania.org

Forumi zhvillohet në kuadër të programit “Mbështetja e Luftës ndaj Pastrimit të Parave në Shqipëri”, zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me Dhomën Amerikane të Avokatisë, me mbështetjen e Departamentit të Shtetit të Sh.B.A.

Programi

10:00 – 10:15	Mirëpritja e pjesëmarrësve
10:15 – 10:20	Fjala hyrëse - Z. Gjergji Vurmo – Drejtor Programi, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
10:20 – 11:20	Prezantim i raporteve informuese 1. Z. Dritan Vakaj, Ekspert kundër pastrimit të parave, TT Compliance – <i>Ndërtimi, Vullkani i Heshtur i Ekonomisë Shqiptare</i> 2. Znj. Ola Xama, Autore Emisioni, MCN TV – <i>Rikthimi i Lojrave të Fatit Përballë Risqeve të Pastrimit të Parave</i> 3. Prof. Hysen Çela, Pedagog, FEUT – <i>Profesionet e Lira dhe Roli i Tyre në Parandalimin dhe Luftën Kundër Pastrimit të Parave</i>
11:20 – 11:45	- Diskutim i hapur mes pjesëmarrësve
11:45 – 12:00	- Përfundimet dhe fjala përmbyllëse
12:00	- Drekë